

UDHËZIM

Nr.1406, datë 30.7.2008

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR DHËNIEN E PËRFITIMIT, NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.869, DATË 18.6.2008 "PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË

14.12.1994 "PËR STATUSIN E INVALIDIT""

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.6.2008 "Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit"", i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. PAGESA E PAAFTËSISË, NË ZBATIM TË PIKAVE 1 DHE 2 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.869, DATË 18.6.2008, DO TË JEPET NGA BASHKIA/KOMUNA, KU INVALIDI KA VENDBANIMIN.
2. INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE LËSHON VËRTETIMIN PËR SHKALLËN E INVALIDITETIT, TË PËRCAKTUAR NGA KMCAP-I, SIPAS MODELIT NR.1 (INVALID I PLOTË NGA SËMUNDJE TË PËRGJITHSHME), MODELIT NR.2 (INVALID I PJESSHËM NGA SËMUNDJE TË PËRGJITHSHME), MODELIT NR.3 (INVALID I PLOTË NGA AKSIDENTE E SËMUNDJE PROFESIONALE), MODELIT NR.4 (INVALID I PJESSHËM NGA AKSIDENTE E SËMUNDJE PROFESIONALE).
3. PËR INVALIDËT QË KANË PËRFITUAR SHITESË, E PAAFTËSISË DERI MË 1.7.2008, PRANË KOMUNAVE DHE BASHKIVE DO TË VAZHDOJNË TA TËRHEQIN PAGESËN ME ATO DOKUMENTE QË KANË DORËZUAR MË PARË. PËR RASTET KUR KOMISIONOHEN OSE JANË INVALIDË PËR HERË TË PARË DO TË PAJISEN ME VËRTETIMIN E RI SIPAS MODELEVE BASHKËLIDHUR.
4. NË RASTET KUR KMCAP VENDOS PËR NDRYSHIMIN
e grupit të invalidit, ndryshimi i masës së përfitimit bëhet në muajin pasardhës (një muaj pas komisionit) të përcaktuar sipas vërtetimit tip të përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi.
5. PËR PERSONAT QË KOMISIONOHEN PËR HERË TË PARË DHE PËRFITOJNË STATUSIN E INVALIDIT TË PUNËS, PAGESA E PAAFTËSISË FILLON NË MUAJIN PASARDHËS PAS DALJES NË KMCAP TË PËRCAKTUAR SIPAS VËRTETIMIT TIP, NË PIKËN 2 TË KËTJË UDHËZIMI.
6. PËR RASTET KUR INVALIDI KA NDRYSHUAR VENDBANIMIN PAS KOMISIONIMIT NGA KMCAP-JA, E RRETHIT ORIGJINË, KA TË DREJTË TË KËRKOJË PAGESËN E PAAFTËSISË NË VENDBANIMIN E RI, MBASI ËSHTË RIKOMISIONUAR NË VENDBANIMIN E RI.

7. Pagesa e paaftësisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.6.2008, u jepet invalidëve, pavarësisht nga të ardhurat e tjera që ato përfitojnë nga pagesat e mbrojtjes shoqërore dhe nuk llogariten në të ardhurat e familjes për efekt të përfitimit të ndihmës

ekonomike.

8. Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore dërgojnë çdo muaj në zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror, listën e përfituesve të ndarë sipas pikës 1/a, 1/b, 1/c dhe 1/ç të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.6.2008.

9. Zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror programojnë nevojat për fonde për çdo bashki/komunë dhe inspektojnë zbatimin e pagesave nga bashkitë/komunat për invalidët përfitues.

10. Zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror dërgojnë në çdo bashki/komunë listën e invalidëve të punës të vlerësuar nga KMCAp-të.

11. Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë njëherë në tre muaj dërgon në zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror, listën e invalidëve të punës të pajisur me dokumentin e identifikimit sipas nenit 4 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, i ndryshuar.

12. Administratorët e bashkisë/komunës përlllogarisin nevojat për fondet dhe përgatisin projektvendimin për miratim në këshillin e bashkisë/komunës për pagesën e paaftësisë për invalidët e punës.

13. Këshilli i bashkisë/komunës, miraton fondin për pagesën e paaftësisë për invalidët e punës.

14. Zyra e financës e bashkisë/komunës, mbi bazën e vendimit të këshillit bashkiak/komunal, përpilon listëpagesën e veçantë për invalidët e punës.

15. Pagesa e paaftësisë tërhiqet çdo muaj në bashki/komunë ku invalidi i punës ka vendbanimin, duke paraqitur dokumentin e identitetit.

16. Në rastet kur invalidi i punës, për shkaqe që nuk varen prej tij, kur: i) komisioni është mbledhur me vonesë; ii) invalidi ka qenë i sëmurë apo për kurim brenda apo jashtë vendit, dhe këto arsye argumentohen me dokumentacion vërtetues, invalidi gëzon të drejtën e përfitimit të pagesës deri në tre muaj vonesë.

17. Administratorët shoqërorë të bashkisë/komunës krijojnë për çdo invalid pune një dosje të veçantë ku depozitohen dokumentet përkatëse që vërtetojnë paaftësinë e tyre.

18. Personat që pretendojnë të përfitojnë pagesën e paaftësisë si invalid pune, paraqesin në bashkinë/komunë ku kanë vendbanimin, çdo fillim viti dhe pas çdo komisionimi apo rikomisionimi, dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesën për përfitimin e paaftësisë si invalid pune;

b) certifikatë personale me fotografi;

c) Vërtetim në origjinal të lëshuar nga drejtoria rajonale e sigurimit shoqëror, sipas modeleve nr.1, 2, 3, 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

19. Udhëzimi nr.682/4, datë 18.6.2004 “Për masën dhe kriteret për përfitimin e paaftësisë nga personat me statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE

DHE SHANSEVE TË BARABARTA

Koço Barka